




Në mbledhje është miratuar edhe ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores së Kuvendit të Lidhjes dhe është sjellë vendim për anëtarë të rinj të Komisionit statutar të jenë Beqir Mexhiti dhe Nikolla Markovski, ndërsa Baki Bakiut i është verifikuar mandati për anëtar të Kuvendit

Mbledhja e 4 e Kuvendit të LSHPM

Rezultatet, nxitje për aktivitete të reja

Më 20.11.2016 është mbajtur mbledhja e katërt e Kuvendit të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, me të cilën ka udhëhequr kryetari i Kuvendit Besnik Pocesta. Në mbledhje janë përmblodhur rezultatet e arritura, por edhe marrëveshja për aktivitete në vitin 2017. Në fillim të mbledhjes, kryetari i LSHPM Dragi Argirovski në fjalimin e tij ka numëruar aktivitetet të cilat kanë shënuar vitin 2016, ndërsa të cilat kryesisht kanë pasur të bëjnë me jubileun e madh të Lidhjes, 70 vjetorin e organizimit të pensionistëve në vendin tonë. Më pastaj, theks të veçantë i dha tetë revyve rajonale dhe revysë së gjashtë republikane të këngëve, muzikës dhe valleve, të cilat disa viteve të



fundit janë mbështetur dhe mbajtur nën patronazhin e Ministrisë së kulturës dhe janë shpallur si manifestime të një rëndësie të veçantë për kulturën e vendit, garave të 21 sportive republikane

në Radovish që është paraqitur si një Olimpiadë e vërtetë sportive pensionale, numrit të madh të piknikëve në gjelbërim ku kanë marrë numr rekord i pensionistëve, Akademisë së

ka marrë çmimin më të lartë deri tani që nga ekzistimi i saj, "Karta e Republikës së Maqedonisë", ndërsa të cilën në mënyrë solemne kryetari të ESHPM ia dhuroi kryetari i shtetit, ekselencia e tij Dr. Gjorge Ivanov. Duke i arsyetuar argumentet për shkak të cilave LSHPM ka nënshkruar Memorandum për bashkëpunim me partinë në pushtet, VMRO-DPMNE, kryetari Argirovski mes tjerash theksoi se gjatë viteve të kaluara pensionistët kanë marrë mjaft beneficione të cilat në mënyrë kualitative kanë ngritur standardin e pensionistëve dhe se thujtje të gjitha kërkesat janë analizuar në mënyrë përkatëse, ndërsa problemet janë zgjidhur në kufijtë e mundësisë së

shtetit. Me fjalë tjera, çdo gjë që është premtuar, është realizuar, madje edhe më shumë se atë. LSHPM në 7 dekadat e kaluara çdoherë ka bashkëpunuar me ato që kanë qenë në pushtet, siç është praktikë në të gjitha shtetet e BE-së, sepse ata janë subjektet që mund të zgjidhin punët që janë në interes të pensionistëve. Pas fjalimit të kryetarit Argirovski si dhe pas diskutimit në lidhje me këtë pikë, kryetari i Kuvendit Besnik Pocesta propozoi konkluzionin në vijim:

Kuvendi i LSHPM në mbledhjen e mbajtur më datë 20 dhjetor 2016, ka konkluduar se duhet të përhëndesë shënimin e dinjitetshëm të 70 vjetorit të organizimit të pensionistëve në Maqedoni dhe të

mohojë sulmet e pabaza tendencioze ndaj LSHPM dhe ndaj kryetarit Dragi Argirovski.

Konkluzioni është pranuar me aklamacion dhe me duartrokitje nga të gjithë të pranishmit.

Në mbledhje është miratuar Propozim – programi për punë të LSHPM për vitin 2017, për të cilën shpjegime për aktivitetet e propozuara në vitin e ardhshëm dha sekretari i KE të LSHPM Stanka Trajkova, si dhe Raportin financiar për punën e LSHPM gjatë periudhës prej 01.01 deri më 30.09.2016, ndërsa është pranuar nga anëtarët e Kuvendit dhe Propozim plani financiar për vitin 2017, i cili është vlerësuar si real dhe gjithëpërfshirës. Të gjitha dokumentet janë pranuar njëzëri.

Në mbledhje është miratuar edhe ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores së Kuvendit të Lidhjes dhe është sjellë vendim për anëtarë të rinj të Komisionit statutar të jenë Beqir Mexhiti dhe Nikolla Markovski, ndërsa Baki Bakiut i është verifikuar mandati për anëtar të Kuvendit. Në fund të mbledhjes kryetari i Kuvendit Besnik Pocesta u uroi Vitin e Ri 2017 dhe u dëshiroi shëndet të mirë të gjithë pensionistëve.

SHP e Strugës ndihmon kategoritë e prekura

Organizimi komunal i Kryqit të Kuq të Strugës gjatë motit ekstremisht të ftohtë, muajin e kaluar në vendet më të prekura malore ka dhuruar ushqim, mjete higjienike dhe batanije për familjet në kushte të vështira sociale, si dhe për personat me shëndet të dobët dhe pensionistët, me qëllim që t'u ndihmohet për të tejkaluar problemet e shkaktuara nga moti i ftohtë. Sekretarja e KK Strugë, Adhurime Dauti, ka informuar se familjet me probleme sociale dhe pensionistët e kësaj kategorie janë detektuar me ndihmën e Qendrës për punë sociale dhe Shoqatën e pensionistëve Strugë. "Vullnetarët e Kryqit të Kuq në periudhën kritike kanë vizituar disa familje nga vendet më të



larta malore, persona të moshuar dhe ata me shëndet të dobët, si dhe familjet me shumë fëmijë në gjendje të

vështirë, të cilët janë furnizuar me ushqim, mjete higjienike dhe batanije me dëshirë që tu ndihmohet në tejkalimin e vështirësive që i ka shkaktuar koha e keqe", theksoi Dauti. Vullnetarët e Kryqit të Kuq të Strugës kanë vizituar familjet në nëntë fshatra, edhe atë: Llukovë, Drenok, Brçevë, Nerez, Bezevë, Frangovë, Jabllanicë, Dellozohdë dhe Novo Sellë. Çdo respekt për humanizmin e këtyre njerëzve. Shembuj të këtyre ka edhe në qytetet dhe komunat tjera ku shoqatat e pensionistëve në mënyrë të shkëlqyeshme bashkëpunojnë me Kryqin e Kuq dhe u ndihmojnë banorëve të tyre më të moshuar që të ballafaqohen me të ftohtin dhe borën.



SHP-Çair me plotë ambicie këtë vit

Tradicionalisht, shoqata e pensionistëve-Çair, organizoi aheng me rastin e përcjelljes së vitit të vjetër dhe ardhjen e Vitit të Ri. Festat e vitit të ri janë rast për takime dhe shoqërim të pensionistëve nga kjo shoqatë. Salla e cila ishte bukur e stolitur, kontribuoi që pensionistët të ndihen të hareshëm dhe bukur. Muzika e bukur, e cila prekte shijen e secilit, i motivonte pensionistët të këndojnë dhe të vallëzojnë. Në kremtimin pensionistët i përshëndeti kryetari i SHP çair, Mentor Qoku, i cili ju uroi me shëndet të mirë dhe me fat t'i kalojnë ditët e pensionimit. "Dëshiroj të vazhdojmë edhe më tutje të punojmë ashtu siç kemi punuar deri më tani, dhe ne mundemi edhe më mirë. Viti i Ri le t'ju sjellë në rrugën e fatit, suksesit dhe shëndetit, të keni jetë të mbushur me dashuri, ndërsa dëshirat t'ju shndërrohen në realitet", tha kryetari Qoku. Ndryshe, si të gjithë takimet e tilla të pensionistëve, edhe ky takim ishte i mbushur me muzikë, këngë, disponim të mirë dhe shoqërim me dëshirë për takim tjetër. Takime të tilla dhe shoqërim kishte në pothuajse të gjitha shoqatat anëtare të USHPM.

Në vitin 2017 aktivitete të shumta në interes të anëtarëve

Së fundi Shoqata e Pensionistëve të Dibrës dhe Qendër Zhupë ka mbajtur Kuvend ku aktiviteti i shoqatës në vitin 2016 ishte vlerësuar pozitivisht, sepse siç ishte theksuar, janë mbajtur aktivitete të shumta në interes të anëtarësisë në komunat Dibër dhe Qendrën Zhupë. Në Kuvend anëtarët e miratuan Raportin për punë në vitin 2016 si dhe Programin për punë në vitin 2017. Sipas kryetarit të shoqatës, Xhavit Karpuzi, gjatë vitit të fundit në shoqatë në të cilën ka mbi 2 mijë anëtarë, janë realizuar shumë aktivitete. Në Raport theksohet se anëtarët e shoqatës Dibër dhe Qendër Zhupa me sukses kanë marrë pjesë në ngjarjet lokale, rajonale, kulturore dhe sportive dhe dru për ngro-



hje në këste për anëtarësinë. Gjithashtu janë shumë të kënaqur dhe në projektin qeveritar për rekreacion falas klimatik dhe të banjës, vikendi falas për pensionistët etj.

Numër i madh i pensionistëve nga dy komunat të cilët ishin në Banjat e Dibrës "Capa" duke shfrytëzuar të drejtën për rekreim falas. Shoqata ka bërë hap të madh dhe me

hapjen e Klubit të pensionistëve në Qendrën Zhupa, në të cilin mbi 500 pensionist në këtë komunë rurale kanë mundësi të rekreohen.

Klubi është realizuar me mbështetjen e projektit të BE-së dhe Qendrës Zhupa. Në seancë u theksua rëndësia e madhe për rehabilitimin e ndërtesës dhe ndërtimin e hapësirave të shoqatës në Dibër. U theksua se SHP Dibër dhe Qendra Zhupa kishte dhe aktivitete të shumta me rastin e përvjetorit të 70 të USHPM. Me këtë rast shoqata ka marrë njohjen nga USHPM. Me programin për punë në vitin 2017 janë paraparë aktivitete të shumta në interes të pensionistëve të të dy komunave.